



## OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT

### DREJTORIA E PROKURIMEVE

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2024

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT (PARAPRAK)

**Drejtuar:** OE “InfoSoft Office” sh.p.k me NIPT J62426002Q  
Tiranë, Kodër Kashar, Autostrada Tiranë - Durrës, Km 8.

**Procedura e prokurimit:** “Procedurë e hapur e thjeshtuar” me mjete elektronike – Mallra.

**Numri i referencës së procedurës:** REF-92229-12-27-2023

**Përshkrim i shkurtër i kontratës:** “Blerje kancelari për nevoja të shoqërisë OST sh.a.”.

**Publikimet e mëparshme (nëse është rasti):** Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 105, datë 29.12.2023.

**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:** Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim.

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

**1. OE “Librari Dyrrahu” sh.p.k. me NIPT L91418502J**

Vlera 2,372,510 (dy milion e treqind e shtatëdhjetë e dy mijë e pesëqind e dhjetë) Lekë pa TVSH.

**2. OE “InfoSoft Office” sh.p.k. me NIPT J62426002Q**

Vlera 2,975,899.55 (dy milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e nëntë pikë pesëdhjetë e pesë) Lekë pa TVSH.

**3. OE “Interlogistic” sh.p.k. me NIPT K21605003M**

Vlera 5,194,350 (pesë milion e njëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e treqind e pesëdhjetë) Lekë pa TVSH.

**Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:**

**1. OE “Librari Dyrrahu” sh.p.k., me NIPT L91418502J, për arsye se:**

Nuk ka përmbushur pikën 2.3.5, të Kritereve të Veçanta të Kualifikimit, pasi skeda teknike e paraqitur rezulton se nuk përmbush specifikimet teknike për Letrën A4 të kërkuar, konkretisht:

Është kërkuar që letra A4 të ketë vlerat: Bardhësia: min 166 – 172.

Është paraqitur letra A4, me vlerat: Bardhësia: 148 – 152.

Ndërkohë, mostra e paraqitur nga OE ofertues nuk korrespondon me atë të paraqitur në skedën teknike.

**2. OE “Interlogistic” sh.p.k., me NIPT K21605003M, për arsye se:**

Oferta ekonomike e paraqitur është më e lartë se fondi limit i përlllogaritur për këtë procedurë prokurimi.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **OE “InfoSoft Office” sh.p.k., me NIPT J62426002Q**, Adresa: Tiranë, Kodër Kashar, Autostrada Tiranë - Durrës, Km 8, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **2,975,899.55 (dy milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e nëntë pikë pesëdhjetë e pesë) Lekë pa TVSH**, është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.